

DOKUMENT PËR POLITIKA nr.6/2023

Dobësitë e kapaciteteve në ballafaqimin me ndotjen e ajrit

AUTOR: MARTINA ILIEVSKA

SHKURT 2023, SHKUP

Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Fondacionit Nacional për Demokraci të SHBA-ve dhe Institutit për Demokraci Societas Civilis - Shkup

Titulli: Po na ha ajri që e shohim dhe/ose korrupsioni që e heshtim

Botues: Instituti për Demokraci "Societas Civilis" - Shkup

Autor: Martina Ilievska

Përkthimi: Vjosa Taipi

Publikimi mund të shkarkohet falas në: <https://idscs.org.mk/mk/2023/02/28/zivotnasredina/>

Dobësitë e kapaciteteve në ballafaqimin me ndotjen e ajrit

Ndotja e ajrit ka qenë një çështje e vazhdueshme në Maqedoninë e Veriut për shumë vite, ndërsa krimi ekologjik¹ dhe korrupsioni është një kontribuues kryesor i problemit. Ndotja e ajrit është një problem i dukshëm gjatë dimrit, ku cilësia e ajrit shpesh bie nën standardet e pranueshme. Kryeqyteti është shpesh një nga qytetet më të ndotura në botë. Vitet e fundit janë ndërmarrë hapa për të adresuar problemin e ndotjes së ajrit, si miratimi i rregulloreve dhe standardeve më të rrepta për emetimet industriale, si dhe nxitja e përdorimit të burimeve të rinovueshme të energjisë. Megjithatë, zbatimi i këtyre masave ka qenë jo konsistent, kështu që progresi ka qenë i ngadalshëm dhe vendi ende përballet me sfida në uljen e niveleve të ndotjes.

Maqedonia e Veriut është një vend që po lufton me ajrin e ndotur dhe kërcënimet mbi mjedisin jetësor, për shumë vite. Ndotja e ajrit është një problem i rëndësishëm, veçanërisht në zonat urbane, për shkak të niveleve të larta të emetimeve nga transporti, industria dhe ngrohja e shtëpive. Efektet e ndotjes së ajrit janë të gjera dhe prekin jo vetëm shëndetin e njeriut, por edhe mjedisin jetësor, ekonominë dhe rrjedhat shoqërore. Është e rëndësishme të kuptohet se si krimi ekologjik¹ dhe korrupsioni kontribuon në ndotjen e ajrit në Maqedoninë e Veriut. Krimi ekologjik mbulon disa aktivitete si prerja e paligjshme e pyjeve, hedhja dhe tregtimi i mbetjeve, gjuetia e paligjshme dhe peshkimi. Në thelb, krimet ekologjike janë aktivitete që janë një kërcënim serioz për mjedisin jetësor. Korrupsioni luan një rol të rëndësishëm në lehtësimin e krimit mjedisor, nëpërmjet legjislacionit joadekuat, lejeve të falsifikuara, lehtësimit të tregtisë së paligjshme deri në injorimin e hedhjeve të paligjshme të mbetjeve dhe ndotës të mëdhenj të ajrit².

Procesi i harmonizimit të legjislacionit vendor me legjislacionin e BE-së, zgjat për dekada. Sipas raporteve të fundit, në një masë të madhe detyrimet ndaj legjislacionit të BE-së për mjedisin jetësor janë inkorporuar në legjislacionin kombëtar³.

Platforma e Organizatave Civile për Luftimin e Korrupsionit në vitin 2022 ka prodhuar një raport ku janë përcaktuar pikat e korrupsionit në mbrojtjen e mjedisit jetësor⁴. Pikat më të vështira janë: mafia e ndërtimit, ndotja e ajrit nga industria, ndërtimet pa leje, keqpërdorimi i burimeve minerale dhe prerjet ilegale. Një mjedis i shëndetshëm është një nga të drejtat e përfshira në Kushtetutën e Shtetit⁵. Çdo aspekt i mjedisit jetësor rregullohet në më shumë se dhjetë ligje, nga të cilat "Ligji për mjedisin jetësor" është kryesori.⁶ Qëllimi kryesor i ligjit është ruajtja, mbrojtja, restaurimi dhe përmirësimi i cilësisë së mjedisit jetësor dhe është baza për krijimin e politikave dhe masave mjedisore. Në lidhje me rregullimin e cilësisë së ajrit, në korrik 2021, u

¹Krimi mjedisor zakonisht i referohet çdo shkeljeje të ligjit ose konventës mjedisore kombëtare ose ndërkombëtare që ekziston për të siguruar ruajtjen dhe qëndrueshmërinë e mjedisit në botë.

²Martini, Maira. (2012). „Environmental crime and corruption“. Transparency International. në dispozicion në: <<https://www.u4.no/publications/environmental-crime-and-corruption.pdf>>.

³Raporti i revizionit: Tatimet për mjedisin jetësor në funksion të zbatimit efektiv të politikave të mbrojtjes së mjedisit jetësor. Në dispozicion në: < https://dzt.mk/sites/default/files/2022-12/172_RU_MZSPP_Danoci_zivotna_sredina_KOMPLET_2022.pdf >

⁴Cekov, Aleksandar. (2022). „Hartëzimi i rreziqeve të korrupsionit në mjedisin jetësor“. Platforma e Organizatave Civile për Luftë Kundër Korrupsionit. Në dispozicion në:

<[⁵Neni 43 i Kushtetutës së Shtetit: Çdo person ka të drejtë për një mjedis jetësor të shëndetshëm. Të gjithë kanë për detyrë të promovojnë dhe mbrojnë mjedisin dhe natyrën. Republika siguron kushte për ushtrimin e së drejtës së qytetarëve për një mjedis të shëndetshëm.](https://www.antikorupcija.mk/2022/02/25/%d0%bc%d0%b0%d0%bf%d0%b8%d1%80%d0%b0%d1%9a%d0%b5-%d1%80%d0%b8%d0%b7%d0%b8%d1%86%d0%b8-%d0%be%d0%b4-%d0%ba%d0%be%d1%80%d1%83%d0%bf%d1%86%d0%b8%d1%98%d0%b0-%d0%b2%d0%be-%d0%b6%d0%b8%d0%b2%d0%be%d1%82/></p></div><div data-bbox=)

⁶Ligji për mjedisin jetësor (Gazeta Zyrtare nr. 53/05, 81/05, 24/07, 159/08,83/2009, 124/2010, 51/2011, 123/12, 93/13, 187/13 42/14, 44/15 129/15, 192/15, 39/16,99/18)

bënë ndryshime në ligjin vendimtar për ndotjen e ajrit, "Ligji për cilësinë e ajrit të ambientit",⁷ qëllimi i të cilit është shmangia, parandalimi dhe zvogëlimi i efekteve të dëmshme mbi shëndetin e njeriut dhe mjedisin jetësor.

Përveç rregullativës së miratuar, ndotja e ajrit mbetet në Maqedoninë e Veriut dhe ka një hendek të dukshëm ndërmjet rregullativës dhe zbatimit. Në vitet e kaluara janë miratuar dhe ndryshuar ligjet kyçe: Ligji për mjedisin jetësor, Ligji për mbikëqyrje inspektuese në mjedisin jetësor dhe Ligji për cilësinë e ajrit të ambientit, por përkundër kësaj kryeqyteti shpeshherë është një nga më të ndoturit në botë.⁸ Në raportin e Komisionit Evropian për ecurinë e shtetit thuhet se "vendi ka një nivel të caktuar gatishmërie" në fushën e mjedisit jetësor, ndaj edhe pse janë miratuar një sërë dokumentesh, zbatimi i tyre mbetet problem. Qeveria duhet të marrë masa konkrete për mbrojtjen e mjedisit jetësor, sepse ligjet nuk mjaftojnë. Duhet të kuptohen sfidat që vijnë në mënyrë që të krijohen zgjidhje efektive.

Ndotja e ajrit si pika e dytë më kritike (sipas raportit të Platformës)⁹, shoqërohet me probleme të shumta shëndetësore, ndërsa korrupsioni shoqërohet me pamundësinë e rritjes dhe zhvillimit ekonomik në vend. Maqedonia e Veriut ka një sërë sfidash që vijnë nga përballja me këtë ndotje të ajrit. Disa nga sfidat që do të shqyrtohen janë: kapaciteti i dobët administrativ, zbatimi i politikave dhe planeve, si dhe mospërputhjet në funksionimin e shërbimeve të inspektimit, si dhe funksionaliteti jo i plotë i laboratorit qendror kombëtar.

Burimet njerëzore cilësore mungojnë në më shumë sektorë në vend. Fusha e mjedisit jetësor nuk është e izoluar nga ky problem, i cili shfaqet si një pengesë horizontale për përballimin e ndotjes së ajrit dhe përmirësimin e mjedisit jetësor. Në raportin e fundit, Komisioni Evropian thekson se ka një kapacitet të dobët administrativ (njerëzor dhe financiar) në disa nivele, të cilat mund t'i përgjigjen dhe zbatojnë legjisllacionin ekzistues.¹⁰

Në lidhje me miratimin dhe zbatimin e rregullores, duhet theksuar se shteti ka vonuar miratimin e ligjeve kryesore (si Ligji për mbikëqyrje inspektuese në mjedisin jetësor)¹¹, në krahasim me kryerjen e masave dhe planeve, efekti i të cilave nuk është i dukshëm. Aktivitetet për luftë kundër ndotjes shpesh krijojnë plane për qytetet me shkallën më të lartë të ndotjes së ajrit, pa raportim transparent të rezultateve.

I tillë është shembulli me zbatimin e planit të Qeverisë - për ajër të pastër, si program strategjik i Qeverisë. Megjithatë, vitet e fundit është vërejtur se ky plan është zbatuar vetëm pjesërisht.¹² Aktivitetet e realizuara tregojnë se ky program është një masë paushall. Sipas raportit të revizionit të ESHR-së, përveç planeve të miratuara, janë veçuar edhe aktivitete si thirrje publike për ndërrimin e pajisjeve dhe inventarit në objekte publike dhe mjete për stacionet matëse dhe instrumentet matëse.¹³ Masat e tilla janë indirekte, i dedikohen matjes, por jo domosdoshmërisht uljes së ndotjes. Revizorët deklarojnë se mjetet nga buxheti i RMV-së dhe

⁷ Ligji për cilësinë e ajrit të ambientit (Gaz. Zyrtare e RM nr. 67/2004, 92/2007, 83/2009, 35/10, 47/11, 100/12, 163/13, 10/15, 146/15).

⁸Deutsche Welle. (23 dhjetor 2022). "IQAir": Shkupi në garë për qytetin më të ndotur në botë"
Në dispozicion në: <<https://www.dw.com/mk/skopje-spered-iqair-povtorno-vo-trka-za-najzagaden-grad-vo-svetot/a-64196835>>

⁹ Cekov. Aleksandar. (2022). "Hartëzimi i rreziqeve të korrupsionit në mjedisin jetësor". Platforma e Organizatave Civile për Luftë Kundër Korrupsionit. Në dispozicion në:
<<https://www.antikorupcija.mk/2022/02/25/%d0%bc%d0%b0%d0%bf%d0%b8%d1%80%d0%b0%d1%9a%d0%b5-%d1%80%d0%b8%d0%b7%d0%b8%d1%86%d0%b8-%d0%be%d0%b4-%d0%ba%d0%be%d1%80%d1%83%d0%bf%d1%86%d0%b8%d1%98%d0%b0-%d0%b2%d0%be-%d0%b6%d0%b8%d0%b2%d0%be%d1%82/>>>

¹⁰Raporti i Komisionit Evropian për R. e Maqedonisë së Veriut për vitin 2022.

Në dispozicion në: https://www.sep.gov.mk/post/?id=5657#.Y_kaaHbMK5e

¹¹Raporti i Komisionit Evropian për R. e Maqedonisë së Veriut për vitin 2021.

Në dispozicion në: <<https://www.sep.gov.mk/data/file/Pregovori/North-Macedonia-Report-2021-%D0%9C%D0%9A2.pdf>>

¹²Dukovska, Jugosllava. (2020). "Raport mbi rreziqet e korrupsionit mjedisor në Republika e Maqedonisë së Veriut". Në dispozicion në: <https://www.osce.org/files/f/documents/e/1/527589_0.pdf>.

¹³Raporti i revizionit: Tatimet për mjedisin jetësor në funksion të zbatimit efektiv të politikave të mbrojtjes së mjedisit jetësor. Në dispozicion në: <https://dzt.mk/sites/default/files/2022-12/172_RU_MZSPD_Danoci_zivotna_sredina_KOMPLET_2022.pdf>

komunave dhe qytetit të Shkupit nuk janë të mjaftueshme për të realizuar aktivitete për uljen e ndotjes. Nevojitet angazhim më i madh dhe gjetja e burimeve të tjera financimi për të reduktuar ndotjen e ajrit.

Puna e shërbimeve inspektuese është vendimtare në (mos) zbatimin e rregullativës. Me miratimin e Ligjit për mbikëqyrje Inspektuese, është kompletuar rregullimi ligjor që mbulon kompetencat dhe mënyrën e veprimit të inspektoratit shtetëror për mjedisin jetësor. Sipas ligjit, inspektor është personi zyrtar me kompetenca dhe përgjegjësi të veçanta të përcaktuara me ligj, i cili kryen mbikëqyrjen inspektuese.¹⁴

Përkundër miratimit të Ligjit për mbikëqyrje inspektuese në mjedisin jetësor, si rregullativë që duhet të përcaktojë kompetencat, shërbimet inspektuese, kanë ekipim të dobët. Kështu, nga viti në vit numri i tyre është në rënie për shkak të daljes në pension apo largimit të inspektorëve në vende pune të tjera. Mungesa e vazhdueshme e personelit e bën të pamundur monitorimin e vazhdueshëm të kushteve mjedisore dhe funksionimin efikas të shërbimeve inspektuese.¹⁵ Për momentin janë plotësuar 55% e vendeve të sistemuara të punës për inspektorë në ISHMJ, pra dy nga tre kryeinspektorë të planifikuar, tre nga nëntë inspektorë të lartë të planifikuar, 15 nga 20 inspektorë këshilltarë të planifikuar dhe dy nga gjashtë inspektorët më të ri.¹⁶

Efekti shtesë i dobët tashmë është vërejtur në Raportin e revizionit për sukses me temë cilësia e ajrit për periudhën 2017-2018¹⁷ ku krahas personelit përmendet mbingarkesa dhe joefikasiteti në funksionimin e shërbimeve të inspektimit. Gjithashtu vërehet përballja me konflikt, mbingarkesa dhe joefikasiteti në punën e tyre me interes për shkak të vëllimit të detyrimeve, mosnjohjes së proceseve tekniko-teknologjike të instalimeve dhe mungesës teknike të pajisjeve.¹⁸ Konflikti i interesit ndërmjet inspektorëve ndodh si përplasje ndërmjet detyrës publike që ata përdorin për interesin e tyre privat.

Ekziston rreziku i konfliktit të interesave gjatë emërimit të inspektorëve komunalë nga kryetarët e komunave. Sipas hulumtimit të Qendrës Informative të OJQ-ve, në shumicën e rasteve, para se të emërohen, inspektorët komunal kanë qenë pjesë e administratës komunale ose kanë qenë këshilltarë në këshillin e komunës.¹⁹

Mungesa e shërbimeve të inspektimit lejon kontroll të ulët të objekteve industriale si pjesëmarrës të drejtpërdrejtë në ndotjen e ajrit. Çdo objekt me leje të integruar A ose B duhet të matë ndotjen dhe t'ia dorëzojë atë institucionit përkatës (Ministrisë ose pushtetit lokal). Sa i përket matjeve, janë vërejtur disa parregullsi, si matja gjatë uljes së kapacitetit prodhues të objektit industrial.²⁰

Një problem shtesë është se shumica e matjeve të ndotësve në ajër bëhet në laboratorë privatë. Laboratori qendror për mjedisin jetësor është akredituar në vitin 2021 dhe aktiviteti parësor është monitorimi i vazhdueshëm i cilësisë së mjedisit (ujë, ajër, tokë). Në të njëjtën kohë, laboratorit duhet të mbështesë Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit Jetësor në aktivitetet e tij të zbatimit të ligjit. Edhe pse ka një rol kyç në monitorimin e gjendjes së mjedisit jetësor, laboratorit nuk kryen analiza të ajrit. Kështu, pavarësisht se është

¹⁴Ligji për mbikëqyrje inspektuese. Gazeta Zyrtare: 102/2019

¹⁵Meta. (4 gusht 2021). "Pesë inspektorë të rinj të mjedisit jetësor do të punësohen në Inspektoratin Shtetëror". në dispozicion në: <<https://meta.mk/pet-novi-inspektori-za-zhivotna-sredina-kje-se-vrabotat-vo-drzhavniot-inspektorat/>>

¹⁶Inspektorati shtetëror për mjedis jetësor. Raporti i dytë gjashtëmuor për punën e ISHMJ për vitin 2022, 1 korrik - 31 dhjetor. Në dispozicion në: <http://www.sei.gov.mk/uploads/9874.pdf>

¹⁷Enti Shtetëror për Revizion. Revizion i suksesit me temë "Cilësia e ajrit"

Në dispozicion në: <https://dzt.mk/Uploads/56_RU_Kvalitet_na_vozduhot_2017_REDUCED.pdf>

¹⁸Dukovska, Jugosllava. (2020). "Raport mbi rreziqet e korrupsionit mjedisor në

Republika e Maqedonisë së Veriut". në dispozicion në: <https://www.osce.org/files/f/documents/e/1/527589_0.pdf>.

¹⁹Hulumtimi: Mbikëqyrja inspektuese komunale - problemet dhe sfidat. Qendra informative e OJQ-ve.

Në dispozicion në: <<https://nvoinfocentar.mk/wp-content/uploads/2020/04/Izvestaj-za-opstinskite-inspekciski-sluzbi.pdf>>

²⁰Dukovska, Jugosllava. (2020). "Raport mbi rreziqet e korrupsionit mjedisor në

Republika e Maqedonisë së Veriut". në dispozicion në: <https://www.osce.org/files/f/documents/e/1/527589_0.pdf>.

plotësisht i pajisur teknologjikisht, për shkak të mungesës së stafit profesional nuk mund të marrë akreditim për analizat e ndotësve të ajrit²¹.

Matjet nga laboratorët privatë hapin mundësinë e korrupsionit, për faktin se laboratorët funksionojnë në baza komerciale, për klientët që kanë objekte industriale që i nënshtrohen detyrimit ligjor. Mosfunksionimi i laboratorit qendror hap mundësi për bashkëpunim të ndërsjellë ndërmjet objekteve industriale dhe laboratorëve. Kur një laborator kryen analiza në instalime për të dyja palët (posedues të lejes së integruar dhe për inspektoratin shtetëror), krijon rrezik për paraqitje të njëanshme të të dhënave nga matjet e kryera.

PËRFUNDIM

Ndërgjegjësimi i ulët ekologjik, kapacitetet e dobëta institucionale, praktikat e këqija dhe masat joadekuate kontribuuan në problemet mjedisore në Maqedoninë e Veriut. Pavarësisht sfidave, ka ende mënyra se si qytetarët mund të ndërmarrin veprime për të ndihmuar në zbutjen e efekteve të korrupsionit ekologjik në Maqedoni. Me rritjen e ndërgjegjësimit për këtë çështje dhe me avokim për rregulla më të forta dhe masa zbatuese, qytetarët mund të bëjnë ndryshime në komunitetet e tyre.

Qeveria duhet të ndërmarrë më shumë veprime, të tilla si eliminimi i aktiviteteve të paligjshme që kontribuojnë në ndotjen e ajrit ose vendosja e rregullave më të rrepta për kompanitë që operojnë në Maqedoninë e Veriut. Vetëm atëherë do të mund të shohim përparim të vërtetë në reduktimin e korrupsionit dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit në Maqedoninë e Veriut.

Në përgjithësi, ka ende shumë punë për të bërë në Maqedoninë e Veriut për të trajtuar ndotjen e ajrit dhe çështjet mjedisore, ndërkaq kjo do të kërkojë përpjekje të përbashkëta nga qeveria, shoqëria civile, sektori privat dhe të gjithë qytetarët.

Rekomandime:

- Shteti duhet të hapë raste në të cilat të gjithë ndotësit do të mbajnë përgjegjësi, gjë që do të imponojë zbatimin e rreptë të dispozitave mjedisore
- Investimi në kapitalin njerëzor cilësor dhe përmirësimi i tij
- Rritja e kapaciteteve të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit Jetësor
- Sigurimi i kushteve për akreditimin e Laboratorit Qendror të mjedisit jetësor për analizë të ajrit
- Krijimi i programeve dhe politikave që mund të zbatohen në mënyrë përkatëse dhe të monitorohet shkalla e zbatimit

²¹Raporti i revizionit: Tatimet për mjedisin jetësor në funksion të zbatimit efektiv të politikave të mbrojtjes së mjedisit jetësor. Në dispozicion në: < https://dzt.mk/sites/default/files/2022-12/172_RU_MZSPP_Danoci_zivotna_sredina_KOMPLET_2022.pdf >

Informacione rreth projektit

Projekti përfshin aktivitete për hulumtim dhe avokim, me qëllim të mbështetjes së procesit të reformave në Maqedoninë e Veriut përmes përforsimit të agjendës së reformave në fushën e sundimit të ligjit, ndërsa për realizimin e këtij qëllimi, projekti parasheh bashkëpunim dhe konsultim me të gjitha palët relevante të interesit në luftën kundër korrupsionit.

Projekti ka për qëllim, së bashku me institucionet kundër korrupsionit të krijojnë një vizion strategjik dhe afatgjatë për zhvillimin e institucioneve në mënyrë që të përgjojnë proceset dhe format e ardhshme të korrupsionit. Përmes projektit, institucionet dhe Instituti për Demokraci do të punojnë në shqyrtimin e proceseve kryesore shoqërore që do të ndikojnë në luftën kundër korrupsionit deri në vitin 2030, ndërsa në bazë të kësaj do të hartohen plane për mënyrën se të përballen institucionet me sfidat moderne të cilat janë rezultat i luftës kundër korrupsionit.

Duke mundësuar dialogun politik ndërmjet institucioneve kundër korrupsionit, Kuvendit dhe shoqërisë civile, projekti synon të arrijë tre qëllime specifike:

- Mbështetje për përmirësimin r procesit të krijimit të politikave, referuar vizioneve afatgjata për rreziqet e korrupsionit dhe mangësive të identifikuara;
- Informimi i planeve afatgjata për zhvillimin institucional, bazuar në të menduarit strategjik dhe analiza nga pozita e së ardhmes
- Edukimi i publikut dhe krijimi i kërkesës publike për planifikim të përmirësuar kundër korrupsionit nga autoritetet.

Informacione rreth IDSCS-ë

IDSCS është tink tenk organizatë, që hulumton zhvillimin e qeverisjes së mirë, sundimin e ligjit dhe integrimet evropiane të Maqedonisë së Veriut. IDSCS ka mision të ndihmojë përfshirjen qytetare në vendimmarrje dhe të forcojë kulturën politike participative. Përmes forcimit të vlerat liberaliste, IDSCS kontribuon në bashkëjetesën e diversiteteve.

Të dhëna për kontakt, për IDSCS

Adresa: rr. Miroslav Krlezha nr. 52/1 / 2, 1000 Shkup
Tel. nr./ faks: +389 2 3094 760,
posta elektronike: contact@idscs.org.mk

Informacion rreth autorit

Martina Ilievka është hulumtuese e re në Qendrën për Qeverisje të Mirë pranë Institutit për Demokraci "Societas Civilis" - Shkup.

